# Formular për SYLLABUS të Lëndës

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | **Fakulteti i Edukimit** |
| **Titulli i lëndës:** | **Zhvillimi psiko-motorik** |
| **Niveli:** | **Bachelor** |
| **Statusi lëndës:** | **Zgjedhore** |
| **Viti i studimeve:** | **I** |
| **Numri i orëve në javë:** | **2+1** |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | |
| **Koha / lokacioni:** | |
| **Mësimëdhënësi i lëndës:** | |
| **Detajet kontaktuese:** | |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës** | *Në këtë lëndë studentët do të kenë mundësi të zhvillojnë njohuri mbi proceset dhe mekanizmat e zhvillimit të aftësive motorike: ndryshimet, proceset dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin motorik. Lënda ofron informacione në lidhje me zhvillimin fizik dhe lëvizor në moshën parashkollore, mjaft të rëndësishme dhe ngushtësisht e lidhur me të gjitha fushat e tjera të zhvillimit. Lënda ofron për studentët njohuri për nocionet themelore, për rëndësinë e zhvillimit të shëndetit dhe atij motorik, informacione rreth procesit të zhvillimit motorik, mënyrës se si fëmijët i mësojnë lëvizjet, inteligjencës kinestetike si dhe ide e aktivitete të cilat mbështesin zhvillimin optimal të fëmijëve në këtë fushë.* |
| **Qëllimet e lëndës:** | *Për të pajisur studentët me njohuri, shkathtësi dhe kompetenca për të promovuar zhvillimin motorik te fëmijët* |
| **Rezultatet e pritura të nxënies:** | *Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jetë në gjendje që të:*<br>o *shpjegojnë nocionet bazë të zhillimit të shëndetit, dhe zhvillimit motorik si dhe komponentëve përbërës të tij,*<br>o *analizojnë karakteristikat dhe stadet e zhvillimit në këtë fushë duke marrë në konsideratë ndryshimet ritmin e rritjes dhe zhvillimit të secilit fëmijë,*<br>o *argumentojnë lidhmërinë mes procesit të edukimit dhe zhvillimit fizik dhe motorik,* |

| | |
|---|---|
| | ○ *përzgjedhin aktivitete që zhvillojnë inteligjencën kinestetike,*<br>○ *ndërlidhin njohuritë e fituara me eksperiencat e jetës së tyre të përditshme profesionale dhe ofrojnë ide për aktivitete praktike edukative në të cilat nxitet ky zhvillim*<br>○ *aplikojnë njohuritë dhe shkathtësitë e fituara në kurs në situata të ndryshme me femijë dhe në jetën e përditshme. (p.sh.. zhvillojnë një planprogram për zhvillimin/stimulimin motorik)* |

**Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithësej** |
|---|---|---|---|
| Ligjërata | 2 | 15/javë | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15/javë | 15 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 2 | 2 | 4 |
| Ushtrime në teren | 5 | 1 | 5 |
| Kollokfiume,seminare | 4 | 3 | 12 |
| Detyra të shtëpisë | 1 | 10 | 10 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 5 | 3 | 15 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final) | 2 | 1/hrs | 2 |
| Projektet,prezentimet ,etj | 1 | 1 | 2 |
| **Totali** | | | **124** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimëdhënies:** | *Ligjërimi formal; ushtrimet/punëtoritë dhe diskutimet në klasë, stimulimi i vetreflektimit, mendimit kritik dhe ndërveprimit grupor* |
| **Metodat e vlerësimit:** | *Vlerësimi i përgjithshëm i studentëve- provimi objektiv 80% e notës; Vijueshmëria- 10% e notës, Punimi individual ose grupor- 10% e notës* |
| **Literatura** | |
| **Literatura bazë:** | *Karaj, Th, (2006). Zhvillimi psikologjik i fëmijës. Tiranë 2006*<br>*Haywood, K., & Getchell, N. (2009). Lifespan Motor Development. Champaign, IL: Human Kinetics Publishers*<br>*Miller, S. (2007). Psikologjia e fëmijës. Tiranë.* |

| **Literatura shtesë:** | *Ross Vasta, Marshall M. Haith, Scott A. Miller, “ Psikologjia e fëmijës” - Shkenca moderne, EUGEN Tiranë 2007*<br>*prof. Dr. Pajazit Nushi, “ Psikologjia e përgjithshme 1 “ Libri Shkollor Prishtinë 2002.* |
|---|---|

**Plani i dizejnuar i mësimit:**

| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
|---|---|
| ***Java e parë:*** | Njoftim me programin, obligimet, metodologjinë e punës, vlerësimin |
| ***Java e dytë:*** | Hyrje ne zhvillimin motorik |
| ***Java e tretë***: | Bazat teorike |
| ***Java e katërt:*** | Tendencat e zhvillimit motorik |
| ***Java e pestë:*** | Shkathtësitë motorike si sisteme dinamike |
| ***Java e gjashtë***: | Kapacitet shqisore dhe perceptive të të sapolindurit |
| ***Java e shtatë:*** | Zhvillimi i hershëm motorik |
| ***Java e tetë:*** | Vleresimi I zhvillimit psiko-motor |
| ***Java e nëntë:*** | Zhvillimi i hershëm perceptiv |
| ***Java e dhjetë:*** | Ndikimi i zhvillimit kognitiv në zhvillimin shqisor dhe motorik |
| ***Java e njëmbedhjetë***: | Ndikimi gjenetik ne zhvillimin shqisor, perceptiv dhe motorik |
| ***Java e dymbedhjetë***: | Ndikimi i rrethit ne zhvillimin shqisor, perceptiv dhe motorik |
| ***Java e trembëdhjetë***: | Çrregullimet e sistemit motorik |
| ***Java e katërmbëdhjetë***: | Çrregullimet e sistemit shqisor |
| ***Java e pesërmbëdhjetë***: | Udhëzime për provim |

**Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

***Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.***

*1. Studentët janë të obliguar të marrin pjesë në kurs rregullisht dhe të jenë pjesëmarrës aktiv në diskutime. Ardhja me vonesë apo lëshimi i ligjëratës para përfundimit të saj nuk janë të lejueshme pa ndonje arsye.*

*2. Në këtë lëndë nuk lejohet nga studentet që të përdorin punimet e studentëve të tjerë, apo të kopjojnë gjatë provimeve në klasë. Studentët e zënë në plagjiat mund të mos e kalojnë kursin sepse ky akt konsiderohet shkelje e rregullave akademike.*

*3. Të gjitha punimet duhet të jenë të shkruara me kompjuter, dhe duhet t’u përmbahen rregullave të shkrimit akademik të cilat prezantohen në klasë.*